



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 241, datë 07.06.2021

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në Kodin e Procedurës Penale, i ndryshuar, në Kodin e Procedurës Civile, i ndryshuar, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

- I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: Largim nga vendi i aksidentit.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: Kultivim i bimëve narkotike dhe Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, {...}, {...}; Objekti: Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik, Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: Dhunë në familje.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Largim i të burgosurit nga vendqëndrimi i detyrueshëm”, parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal.

8. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Artan Hajredinaj (relator), Elsa Ulliri dhe Jak Ndoka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: {...}, {...}, etj; Akuza: “Nenet 284/2, 283/2, 278/2, 278/3, 287, 248 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Durrës si vijon:

- 1.1 Kërkesës nr. 469 prot., datë 01.06.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Padiës: {...}; I paditur: Përmbaruesi {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave së Gjykatës së Apelit Gjirokastrë si vijon:

- 1.1 Kërkesës nr.513 prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}, personi i tretë: {...}, etj, objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”;
- 1.2 Kërkesës nr.514 prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Padiës: {...}, I paditur: {...}sh.p.k, person i tretë: {...}, objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimor”;
- 1.3 Kërkesës nr.515 prot., datë 31.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}, person i tretë: {...}, etj., objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”;
- 1.4 Kërkesës nr.516 prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}, person i tretë: {...}, objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkesë: {...}, objekti: "Pezullim ekzekutimi vendimi civil".

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Korçë si vijon:

1.1 Kërkesës nr. 593 prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Ankues: {...}; Objekti: “Ankim kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, datë 13.07.2020”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, etj.; Akuza: “Trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR